VENDIM
Nr. 643, datë 5.10.2022

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT PËR PLANIFIKIMIN KOMBËTAR SPITALOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor, si organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me 9 anëtarë, si më poshtë vijon:

a) Prof. Arben Gjata	mjek kirurg;
b) Prof. Anila Godo	mjek pediatër;
c) Prof. Dr. Kozeta Sevrani	ekspert i ekonomisë dhe menaxhimit;
d) Prof. Arben Baboci	mjek kirurg kardiak;
e) Prof. Asc. Durim Çela	mjek radiolog;
f) Prof. Mihal Tase	mjek internist;
g) Prof. Dr. Orion Glozheni	mjek obstetër-gjinekolog;
h) Prof. Ass. Edmond Zaimi	mjek urgjentist;
i) Prof. Asc. Alban Ylli	profesionist i shëndetit publik;

2. Anëtarët e Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor zgjidhen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Komiteti për Planifikimin Kombëtar Spitalor, gjatë veprimtarisë së tij, asistohet nga sekretari i këtij komiteti, i cili është një specialist pranë drejtorisë përgjegjëse për politikat dhe menaxhimin e shërbimit spitalor në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

4. Kryetari dhe nënkryetari i komitetit zgjidhen nga anëtarët e këtij komiteti në mbledhjen e parë me shumicë votash.

5. Komiteti për Planifikimin Kombëtar Spitalor mblidhet me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe kryen këto funksione:

a) Analizon situatën aktuale të shtrirjes së shërbimit spitalor në vend;

b) Vlerëson nevojat dhe kapacitetet spitalore kombëtare, bazuar në kriteret territoriale, demografike, socioekonomike, barrën e sëmundshmërisë, si edhe në plotësim të kërkesave didaktike dhe shkencore të edukimit mjekësor;

c) Paraqet për shqyrtim pranë ministrit Planin Kombëtar Spitalor;

ç) Jep mendime për çështjet e përcaktuara në nenin 6, të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", si dhe për çështje të tjera që lidhen me politikat spitalore të kërkuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

6. Vendimet e komitetit merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

7. Vendimi nr. 403, datë 19.6.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Shtetëror për Planifikimin Spitalor", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku